

VOJSAVA NELO

ITAKA IME

POEZI

BOTIMET TOENA

VOJSAVA NELO

ITAKA IME

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor: Adem Jakllari

Përkujdesja grafike: Mirjana Madhi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN: 978-9928-376-92-3

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

“Në çdo fjalë je pasion, shpërthim,
gjithmonë më tej se e zakonshmjia.”

AVNI DELVINA

VLERËSIME PËR SHKRIMTAREN VOJSAVA NELO

Vojsava Nelo është një poete e talentuar. Vojsavën, në fillim, e njoha si një nga poeteshat e reja që vinte në poezinë shqipe, nëpërmjet cikleve që botonte në gazetën “Drita” dhe revistën “Nëntori”, në vitet ‘70. Që atëherë më ka bërë përshtypje për ndjeshmërinë e thellë që mishëronte. Më vonë, me botimin e librave, do të vihej re gjithnjë e më qartë se poezia e saj është poezi e një gruaje delikate, e brishtë, e ndjeshme, një poezi që del nga shpirti. Një poezi transparente, e bukur, me nivel të lartë artistik dhe plot muzikalitet. Krijimtaria e saj në vijim, vërtetoi atë mendim që pata që në krye, se Vojsava Nelo ishte një poeteshë e vërtetë, origjinale, e veçantë. Poezia e saj është një poezi që nuk të lë indiferent, por të bën për vete. Ka identitetin dhe figuracionin e saj, metaforat dhe mjetet e tjera artistike. Nuk përzihet libri dhe emri i saj si autore me emra të tjerë. Vojsava Nelo ka “Vizën Shengen” në poezi, vizë që ajo e ka marrë vet. Poezia e saj është spontane dhe të kujton atë që thotë Tolstoi, shkrimtari gjenial i shek. XIX, “krijimtaria është si tështima, që kur të vjen, nuk e mban dot”. Dhe Vojsavës i vjen për të shkruar dhe shkruan poezi siç e ndjen, siç e përjeton nga shpirti.

Dritëro Agolli

Sa herë risjell në kujtesën time apo diskutojmë me miq, shkrimtarë e artistë, mrekullohem se si shpërthyen në ato vitet 1973-1977 një plejadë studentësh, poetësh dhe poeteshash aq të talentuar, që tanimë kanë bërë emër dhe radhiten me meritë në antologjinë e poezisë më të ndritshme aktuale shqipe. Mes këtyre studentëve të shkëlqyer, mes këtyre talenteve zë vend, në krye të listës, një vajzë e bukur, e gjallë dhe shumë e talentuar, Vojsava Nelo.

Shumë vajza shkruanin dhe shkruajnë poezi, por mjerisht, shumicës nuk ua dëgjoj më zërin pasi martohen e bëhen nëna. I merr me vete vorbulla e halleve të jetës... Të rralla janë ato që i qëndrojnë kohës dhe nuk ka rrebesh që ua shuan nga shpirti poezinë, pranverën. Një ndër to është Vojsava. Ajo vazhdon të jetë “pranverë”, sepse pranvera është poezi dhe ajo kurrë nuk pranon acarin dhe ngricat.

Vojsava ka lulëzuar mbi to. Në kujtimet e mia, ish-studentja ime, Vojsava Nelo, ka ngelur si ngel pranvera në zemrat tona. Ka ngelur POEZI E FYTYRËS DHE E SHPIRTIT.

Fadil Kraja

Vojsava Nelo është një nga shkrimtaret më të zëshme të ditëve tona me një krijimtari paralele si në prozë ashtu dhe në poezi.

Vepra e saj shquan për humanizmin e gjerë, sinqeritetin, begatinë e ndjenjës dhe poetikën e fjalës, sidomos në romanet e saj realizohet një arkeologji e thellë dhe e gjithanshme e shpirtit të trazuar të bashkëkohësit shqiptar. E pandikuar nga eksperimentet shterpe që kanë përfshirë jo pak krijues të ditëve të sotme, Vojsava ecën në gjurmët e traditës më të mirë të shkrimtarisë sonë duke pasur gjithmonë në qendër njeriun me tërë kompleksitetin dhe zhvillimet shpirtërore të tij. Ajo fokusohet në mënyrë të veçantë te metamorfozat dhe dilemat e forta të qenies, tek udhëkryqet dramatike në të cilat gjendet njeriu shqiptar, dhe jo vetëm, dukuri të cilat shkrimtarja i kundron të lidhura fort me zhvillimet politike dhe shoqërore. Në këtë mënyrë, vepra e shkrimtares së njohur, fiton edhe një theks të dukshëm qytetar.

Një tjetër përmasë e rëndësishme e krijimtarisë së Vojsavës është dhe poetizimi i së bukurës dhe i të dëlirës.

E joshur përjetësisht ndaj qiellores dhe fluides, veçanërisht në poezi, autorja ndërton një univers

letrar tërë dritë dhe harmoni. Ky peizazh letrar që sundon në poezinë e poetes shkon përshtat edhe me atë *joie de vivre* të bollshme që hijeshon portretin e saj njerëzor.

Me interes është të nënvizojmë se krijimtaria e Vojsava Nelos ka për shtrat gjeneze qytetin e saj, Delvinën, një lokalitet ky i bukur dhe i pasur i vendit tonë. Është kjo pasuri historike, njerëzore dhe natyrore, muza e vërtetë e shkrimtares; janë historitë njerëzore të qytetit, fatet dhe dramet e tyre që lëvizin të transfiguruar në art nëpër faqet e librave të Vojsavës.

Në të gjithë krijimtarinë e saj regëtin pulsi, ritmi, rreh zemra e qytetit të saj, Delvinës.

Është një rast unikal, do të thoshim, në të cilin gjenden në një simbiozë të plotë qyteti i lindjes, shkrimtari dhe krijimtaria letrare.

Adem Jakllari

Të dashur lexues, adhuronjësit e penës sime, jo rrallëherë më qëllon të më pyesin se ku qëndron sekreti i punës sime, i rrugëtimit tim artistik.

Më në fund, mendoj, se e kam një përgjigje.

E gjithë puna ime, në të vërtetë, mban në vetvete një sekret: forcën dhe vitalitetin për të ecur, për të mbërritur, dhe prapë për të ecur...

Sekreti i forcës sime janë rrënjët. Jam mbajtur fort pas tyre dhe, kur them rrënjët, nuk kam parasysh thjesht rrënjët e mia biologjike.

Jo!

Kam parasysh rrënjët që më kanë ushqyer shpirtërisht, artistikisht, moralisht, e që janë rrënjët e trevës ku linda e u rrita, të qytetit nga vij, qytetit dhe qytetarisë, që më kanë bërë kjo që jam.

Vojsava Nelo

DELVINA

O vend i adhuruar! Vendlindja ime e shtrenjtë!
O mall i kaltëruar! O flad që dallgëzon
e fryn fletë më fletë!
O fushë e lulëzuar! O mall që shpirtin djeg!
O tokëz e bekuar, sot e përjetë!

Burime që vijnë me oshtimë,
e në muzikë shndërrohen brenda kraharorit tim.
Gurgullon kraharori. Shpirti im.
Zgjohen mallet që flenë.
Kohët që s'kthehen kurrë më.
Çdo gaz.
Çdo lot.
Çdo përjetim.
Këtu, në vendin tim.

O vend i adhuruar!
O zjarr i shpirtit tim!

ITAKA IME!

Mbërrite, Sava?!

- i them vetes.

Hidhe spirancën!

Ankorohu!

Është Itaka jote këtu.

Buzë këtij deti blu.

Po nuk arrita.

Se nga mbërritën ca erëra të forta?!

Se si ngritën ca dallgë të mëdha?!

Se si më përlanë e më vërtitën,

nëpër ca dete, shkulum e zhurmë,

nëpër ca dete, nëpër ca brigje, oh, sa të largëta?!

Aty më lanë. Më përplasën.

As gjallë, as vdekur,

kur sa mendova se, më në fund,

Itakën time kisha mbërritur.

Isha rikthyer, gjallë a vdekur.

Por vijnë ca dallgë, po vjen një shkulum,

e më rrëmben.

E prej këtej, ku jam përplasur,
më duhet rishtas që të nisem.
Itakën time ta rigjej.

Itaka ime! Po nisem prapë.
Dhe pse sërish fryn erë e marrë.
Dhe ngre ca dallgë, oh ç'dallgë, Itakë,
që më kanë çuar, nuk di sa larg?!

Itaka ime, po nisem prapë!

NË DELVINË

Mbështetur jam në rrënjët e mia.

Në truallin tim.

Degët zgjaten..., shtrihen tutje...,

Mbushur zogj këngëtarë,

Erë...

Thëllim...

Po trangu i fortë qëndron në këmbë

Pa më të voglin dëmtim.

Gjethet që ranë do të riçelen,

në pranverat që do të vijnë.

Plot e përplot jam.

Me ajrin e freskët. Flladin që fryn.

Çerdhe të reja zogjsh,

dhe atë këngën time të përhershme

atë këngën time,

pikuar nga yjet që ndrijnë.

Në rrënjët e mia,

Në truallin tim.

VEÇ TË JESH NË DELVINË

Delvinë, o e bukur,
qyteti im i dashur!

Menekshetë e Delvinës, trëndafilat dhe zambakët,
mbushnin kopshtet dhe oborret,
dritaret dhe mëngjeset.

Shto dhe diellin me rreze.

Veç të jesh në Delvinë.
Veç të jesh ato mëngjese!

Tiranë, maj 2019

TROJA

“Troja” shkëlqen nën dritën e diellit...

“Trojanë”!

Kudo jeni,
paçi bekimin e tokës dhe qiellit!

Të të parëve tanë,
që në paqe e qetësi flenë.
Se “Troja” ka lindur e do të lindë “trojanë”
të shkëlqyer, ngaherë.

“Troja” jonë! Shpirti ynë!
Gjaku që rrjedh nëpër vena,
nëpër dej...
Nga brezi në brez.
Nga koha në kohë.
Nga legjenda në legjendë.

“Trojanë”!

Kjo është “Troja” jonë,
dhe ne, “trojanët” e saj.

Tiranë, 14 shkurt 2023

SI NJË STATUJË MBRETËRORE

Duke ecur,
mes një toke pjellore
në ca kodra të gjelbëruara
mbushur me puhizat e lehta që tundin degët e pemëve.
Mes një dite të bukur
mbushur me njerëz të gëzuar
si të jenë nisur në një festë të madhe, së bashku,
së bashku për të festuar.

Unë, nën degët e ullinjve
bëj një kurorë,
si për të festuar, së bashku me njerëzit,
dhe e vendos mbi krye.
Me një gjest princëror.
Si mbretëreshat e antikitetit,
ku prej mijëra vjetësh dielli i madh
shkëlqimin aty e lë.

Nga mëngjesi në mbrëmje.
Aty vezullon prej mijëra vjetësh,
romanca e ëmbël e çdo hënë.

Mes për mes kësaj toke arbërore,
kësaj dite të gëzuar.
Si një statujë përjetësisht mbretërore,
përjetësisht, duke poetizuar.

E hënë, gusht 2019

ARTEMIDA

*Artemida, një vajzë e shkëlqyer, një nxënëse ekselente!
Ajo do të ngelet një ndër margaritarët e shkollës
“Mihal Grameno”, Tiranë.*

*Meridiana Nepravishti,
ish-mësuese e Artemidës.*

Mirëmëngjesi, o e Bukura e Dheut!
Rrezja e parë diellore,
shkëlqim e dritë!
O e Bukura e Dheut,
mirëmëngjes!
Dhe afrohem,
dhe e puth,
ëmbël,
lehtë.

Ajo përhap atë dritën e saj të madhe,
pa të cilën s'do të mund të ekzistonte ky shpirt.
Kjo jetë.
pa të cilën,
s'do të mund të kishte lindur dot ky mëngjes.

KËTU PUNOJNË MAGJISTARËT

“Këtu punojnë magjistarët.”

Boston.

“Këtu punojnë magjistarët.”

Shkruhet në hyrje të Institutit tënd.

E lexoj dhe e rilexoj,

dhe çfarë s’më vërtitet nëpër mend!

Sepse unë e di që ti bën shkencë.

Këtu thotë se bëni “magji”?!

Se jini magjistarë të vërtetë,

në këtë vend,

ku lulëzon dije dhe liri.

Unë e di se ti bën shkencë,

i shtrenjti biri im, dhe jo magji?!

Po kjo qenka shumë e vërtetë,

sepse e lexoj me sytë e mi:

- “Where Wizards Work”,
Këtu punon dhe im bir.
Të jetë kjo ëndrra e madhe
që gëloi herët në shpirtin e tij?!

Të jetë ky vegimi i artë,
Itaka zhuritëse, të jetë?!
Dashuria e madhe,
e zjarrtë,
e birit tim të shtrenjtë?!

Ndoshta..., ndoshta...,
nuk e di...
Rreth e qark vërtiten “magjistarë”.
Im bir më shpjegon me qetësi,
duke më përkthyer fjalë për fjalë!

MADHËSHTORE KJO QË PO NDODH

Midis realitetit dhe magjisë

U ndezën motorët për nisje.
Nata po bie ndërkaq.
Varkat e vogla dalin për shëtitje,
si ta bënin magjike këtë natë.

Pak më tej kroçiera u nis.
Si një pallat që lëviz nëpër det.
Dielli sapo dha shpirt.
Duke lënë pas ca përjetime,
ndërsa zhytej në horizontin e kuqërremtë.

Unë këtu, përpirë nga kjo natë.
Nga ajo nisje e ëndërrt,
e ngadaltë.
Nga ajo fikje diellore, si e mbinatyrshme.
Nga ai muzg i kuqërremtë.
Nga ato varka të vogla si magjistare të mëdha
nëpër det,
që ma mbajnë shpirtin peng.

Madhështore kjo që po ndodh
këtë mbrëmje që filloi të shndrisë.
Dhe unë, dhe unë, që kolovitem e përhumbur,
midis realitetit dhe magjisë.

Sarandë, gusht 2017

DALLËNDYSHET

Dallëndyshet varg e varg, ja po vijnë.
Këngë kanë në gojë, krahëve kaltërsinë.
Ulen e pushojnë mbi supet e fëmijëve, cicërijnë...
Këngë e tyre sot më flet për dashurinë.

Me këto dallëndyshe ngjajnë fëmijët tanë të mirë.
Në ëndrrat e tyre kanë fluturimin, lartësinë...

Dallëndyshet venë e vijnë sërish.
Vogëlushët u ndërtojnë foletë.
Moj pranverë e dashur, e bukura stinë,
çelur te kjo tokë përjetë..., përjetë...!

** Kjo poezi është teksti i këngës me të njëjtin
titull, "DALLËNDYSHET"
Kompozitor: Franc KODHELI
Kënduar nga: Telemak PAPAPANO,
Festivali i Delvinës, viti 1985*

KARVANI IM I NDRITSHËM

*Aliche dhe Arthur nuk e dija se do më bënit
kaq të lumtur!*

Anastasia pastaj, Gabrieli, shembi çdo kufi.

*Gjyshja juaj,
Vojsava Nelo*

Sodis Universin...

Universi shkëlqen nga mijëra e miliarda yje,
me një dritë kaq të bukur,
të shndritshme!

Ndërsa pret të lindë një i ri,
mbështetur pas një ëndërrimi,
që i jep formë yllit
që do të shkrepë.
Do të ndrijë.

.....

.....

Lindi!
Lindi ylli i ri!

O Perëndi!
Tri yje tani!

Ylli i Karvanit, biri im, GENTI.
Ylli i Mëngjesit, bija ime, ARTEMIDA.
Dhe një i ri, një yll i ri që sapo lindi,
dhe ne e quajtëm me emrin, ALICE!

Një kostelacion i ri, një yllësi!
Së bashku lëshojnë dritë, shkëlqejnë,
mbi çdo yllësi ndoshta, që ka lindur e do të lindë
ndonjëherë,
në të gjitha sistemet diellore
që thonë, se ekzistojnë në Gjithësi.

Karvani im i bukur, i ndritshëm,
si një karvan princëror mes për mes universit,
këtë çast të madh,
këtë orë!

Po një i ri,
po një i ri që ka lindur e nuk jua rrëfej dot?!
Një i ri me emrin ARTHUR.
Që është Ylli i Bukurisë.
Që e mbushi shkëlqim e dritë këtë botë.
Që e ëmbëlson kaq shumë këtë shpirt.
E që pa frikë, mund ta quash, Ylli i Mirësisë.
ARTHUR!

Po prisni, prisni.
Kostelacioni im po rritet.
Universi im po shumëfishohet.
Lindin yje të reja.
Marramendëse.

Prisni, prisni, mrekullinë që s'ua kanë parë sytë.
Një yll margaritar,
Një yll i rrallë me një shkëlqim të panjohur,
është duke ardhë.

E kanë kapur radarët e shpirtit.
Muzat e mia e kanë dalluar, e kanë parë.
Një yll i rrallë është duke ardhë.

Mbërriti, o Zot!
Sapo.
ANASTASIAAA!

Anastasiaaaa!
Dhe përulem thellë.
Dhe falënderoj Zotin,
Perënditë,
me qindra, miliona
e miliarda herë.

Milano, 12 nëntor 2019

MELODIA E VENDLINDJES

Delvina

Dëgjoj rreth e qark një melodi.
Më ndjek ngado shkoj.
Ngado vete.
Është një melodi e ëmbël,
si melodi shpirti.
Është një melodi e vetme.
E që unë e ndiej midis mijëra e miliona njerëzve.

Nuk është thjesht një këngë, thjesht një melodi.
Është një simfoni.
Simfoni e vendlindjes sime.
E papërsëritshme.
E njoh mirë. E ndiej.

E madhërishtme,
një simfoni ujërash dhe çeljesh pranverore.
Flladësh,
dhe njerëzish, të vetmit në botë.
Vajzash dhe djemsh që bien në dashuri,
ja, nga kjo melodi

që ndiej rreth e qark,
ndërsa muzgu avitet duke mbështjellë botën ngadalë,
pak e nga pak me një romantikë të papërballueshme,
me një mister,
si me mëndafsh.

Mallet dhe horizontet ndizen...
Marrin flakë.

Melodia e vendlindjes sime,
në shpirtin tim,
në mish,
në gjak.

*Shkruar në fluturim, në linjën Milano-Tiranë,
17 janar 2016*

NËPËR TINGUJT E NJË VIOLINE

Ankth dhe gëzim.

Pasiguri

dhe rrëfime....

Nëpër të gjithë tingujt e ëmbël e të trishtë
të kësaj violine që ndihet,
që brenda gjirit të natës.

Kush të jetë,

me këta tinguj të dridhshëm,

që prek të gjitha ndjesitë?!

Të gjitha humbjet.

Të gjitha dashuritë.

Të gjitha plagët.

Yjet u bënë prush.

Yjet e largëta...

FËMIJËRIA...

Fëmijëria ime,
jeta ime e jetuar,
jeta ime e gëzuar.

E bukura fëmijëria ime që shndrit e vezullon para
syve të mi,
gjithë kohën e kohës.
Po kur ndalem, kur ndalem e rri dhe e të sodis...
Ndalem dhe e përballuar rri e të shoh...
E mrekullohem...

Dhe e kuptoj, e kuptoj se falë saj,
botën e mbush me dashuri,
dhe si me fije ari,
e qëndis me poezi.

Tiranë, e mërkurë, 8 maj 2019

NUSËRORE

Shikimet e saj fluturonin me retë
ëndërruese.
Mes për mes qiellit.

Pa u ndalur.
Pa u lodhur.
Në shtegtime të largëta
tok me retë.

Shikimet
dhe një ëndërr gurgulluese
që përvëlonte,
ndërsa priste çastin e shenjtë.

NUSËRIA IME

Tej horizonti mbushur male e kodra,
mes grykash fshihet e shfaqet
fshati i tim shoqi
si hëna përmes reve netëve të ngrohta,
kur me marrëzitë e poetëve do të lozi.

Unë zgjas kokën nga dritarja,
sodis,
makina merr kthesat radhë-radhë,
më shfaqet aty,
midis malesh të hirta,
nusëria ime e bukur,
zanë!

Më shfaqet e më ikën nga sytë
sikur përmallimin kërkon të ma shtojë,
përmallimin tim që më ka pushtuar krejt,
e më bën paksa të lotoj.

Se unë ika një ditë. Ti mbete, ja, këtu,
në këto gryka,
ku fryn e bie shi.
Sa herë netëve borëron,
unë përpëlitem,
unë nuk mbyll sy!

Unë çohem nëpër natë si e marrë
dhe dal e të kërkoj nëpër stuhi.
Por ti nuk dukesh kurrkund
moj e bukur,
ndërsa gjëmon e bie borë...
shi...!

Unë pyes veten nëpër natë,
nëpër borë
ndërsa të kërkoj me qiri.
Ç'muzë të sollli gjer në këto gryka,
o Zot, mund ta di?!

Mos më mbaj inat në përjetësi
se unë s'doja të të lija nëpër male.
Kush të degdisi?!
Mizori!

Mizori, që ti më mbete,
breng' e madhe!

Dale mos më ik,
Qëndromë pak përballë, qëndromë!
Qëndromë të të shoh,
se unë nuk kam faj,

Ajo e veshur me një fustan të bardhë,
përjetësisht nëpër gryka,
brenda fatit të saj!

DET ME LULE TRËNDELINË

Mbolla një fushë me lule trëndelinë.
Të gjitha lëndinat i mbolla,
lule trëndelinë,
nga ato që rriten viseve të mia.
Nga ato që rriten në Delvinë.

Mbi lulet e verdha erdhën flutura
e u ulën për pak.
Pastaj përplasën krahët e ikën,
ndoshta diku afër, ndoshta diku larg.

Ndoshta në ëndrrat vajzërore,
fluturuan gjithë dëlir.
Fluturat e bardha vallëzojnë në ajër,
në një hapësirë të pamatë
det me lule trëndelinë.

Delvinë, pranverë më pranverë.

IMAZH

Në Delvinë

Dukej sikur yjet ndriçonin në kopshtin tonë.
Dielli, gjithashtu, ndriste mbi atë çati.
Dhe hëna lozonjare natën dukej,
se e kalonte aty.

Në Delvinë, në Papuçi.
Në shtëpinë përrallore të gjyshërve të mi.

RINIA IME

Rinia ime, ka qenë një vjeshtë.
Disa e dashurojnë. Shumë.
Po unë s'e kam dashur kurrë.
Vjeshtën.
Vjeshtën që ka qenë tek unë.
Ditët që zverdheshin,
e binin në formë gjethesh.

Trishtohesha unë.

Me dimrin në prag.
Vjeshtën thuajse s'e kam dashur kurrë.
Dhe si një fëmijë i vetmuar,
nga gjethet që binin, trishtohesha unë.
Dhe gjëmimet që fillonin të ndiheshin pas pak,
më trembnin shumë.

Pa le kur vinte e ulej këmbëkryq dimri.
Unë, përballë tij.
Ai, dimri i egër, i çmendur,
zhurmë e rrokopujë.

Unë, përmes tij e lënë e vetme, trembesha.
Oh, sa jam trembur unë?!

Rinia ime, dhe thuajse gjithçka më pas,
të gjitha stinët: dimër, verë, pranverë, vjeshtë,
si vjeshtë e zverdhur
që u venit ditë për ditë,
pak e nga pak.

Rinia ime, që s'të gëzova dot.
Rinia ime, si gjithë jeta, nëpër tym e nëpër flakë.

JU PUTH BRIGJET E MIA

*“Unë jam ancoruar përjetësisht këtu, në brigjet e mia.
Në brigjet e mia, shkruaj përjetësisht poezinë time.”*

Qenia ime,
shpirti im
ankoruar përjetësisht këtu,
në brigjet e mia.
Këtu unë shkruaj përjetësisht poezinë time.

Ju puth, brigjet e mia!
Ju pikturoj në shpirtin tim
me penelin e artë të Perëndive.
Me frymën dhe pavdekësinë e tyre.

Unë ancoruar përjetësisht këtu.
Këtu, deti im i poezive!

Në Sarandë, mars 2019

UNË STRUKEM NË ATË GJI TË VOGËL

*Në Sarandë, tek hotel “VOLA”, ku zgjedh të pushoj
dhe të shkruaj.*

Unë strukem në atë gji të vogël të atij qyteti
bregdetar
dhe sodis qiellin...
Horizontin që po përfshihet nga flakët,
dhe detin e madh.

Varkat e vogla me vela të bardha,
që sapo u nisën.
Tragetet e mëdha.
Dhe aty-këtu ndonjë peshkatar,
që hedh rrjetën
në detin me valë.

Unë strukur, këtu, në këtë gji të vogël,
si një e vogël.

Në këtë oazë mrekullie.

Dhe humbas si në detin me valë,
në detin tim të poezive.

Sarandë, verë më verë.

ALASKA IME

Ai horizont aty, miniera ime.
Prej andej nxjerr mineralet e çmuara.
Alaska ime, ajo e viteve të para,
sot e në vazhdim,
Alaska ime me thesare të rralla.

Ai horizont aty, ku perëndon dielli mbrëmje më
mbrëmje.
Për të lindur një i ri të nesërmen.
Mëngjes për mëngjes.

Duke ndezur imagjinatën time,
imagjinatën time, që nuk e bëj dot zap.
Nuk e frenoj dot.

Sapo vjen mbrëmja e zhytem aty,
në minierën time të artë,
në Alaskë.
Ai perëndim dielli aty, në Sarandë.
Prej andej nxjerr thesare: vargje, poezi.
Të gjitha të arta, thonë,

me një shkëlqim që vezullon kraharorëve,
shpirtrave të njerëzve,
duke i tallazitur.

Duke i dehur.

Duke i çmendur, ndoshta,
sikur t'u jetë bërë magji atyre dhe mua
nga ai horizont i flakëruar,
ndërsa dielli varet për të perënduar...

ALËT E DETIT LËKUNDIN ANIJET

Valët e detit lëkundin anijet,
botën dhe trillet e tyre.
Pulëbardhat vallëzojnë duke përhapur motive
detesh,
dhe njerëzish që udhëtojnë
duke mbartur të sotme, të ardhme, të djeshme.
Ëndrrën dhe zhgjëndrrën.
Valët e mëdha, të zhurmshme, e plot forcë.

Valët lëkundin anijet
ditën, natën.
Bota fle pak më tej.
Hera-herës mbërrin aty jehona e dallgës.
Bota,
e mësuar me zërat e detit.
E mësuar me dallgën.
Me frymëzimin e përzjetshëm të poetit.

Fle. Bota.

Dhe hera-herës ndien jehonën e dallgës
dhe këngës që lind
në mes të natës.

I DALLGËZOHET DETI!!

Si dallgëzohet deti,
si shpirti.

Po unë e di.

Ka dhe paqe. Ka dhe qetësi.

Shpirti, shpirti i njeriut,
dhe deti.

Deti që fërshëllen brigjeve përmes shkulmeve të erës,
që vazhdon të fryjë...,
vazhdon të sokëllijë...

Sarandë, 2019